



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 864/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi i kryesuesë, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Skender Qorri nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.864/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Skender Qorri nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave për subjektin e tyre politik në Komunën e Gjakovës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Skender Qorri nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike, dega në Komunën e Gjakovës, i cili thekson se nga rezultatet finale të publikuara nga ana e KQZ-së për dallim nga ato preliminare e nxjerrin subjektin politik IRDK me gjithsej 493 vota, duke ia pamundësuar ulësen në asamblenë komunale të Gjakovës, pasi që numri total i votave zvogëlohet për 90 vota e për të cilën subjekti politik IRDK e humb ulësen në kuvendin komunal të Gjakovës. Parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohet dhe të analizohet rënia e rezultatit të tyre.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, por vetëm ka ngritur dyshime se i mungojnë votat, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe

bindëse konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për subjektin politik IRDK, për të cilën dyshon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime sepse pritjet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritjet e bëra nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.864/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.